

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE TREGTARE
“ALB – CNG” Sh.a.**

Sot më datë 01.12.2022 ishin te pranishem:

Blankbank Investments Limited, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Departamentin e Regjistrimit të Kompanive të Qipros me numër HE224529, me seli në 12, Rruga Egypt, Nicosia, 1097, Qipro, përfaqësuar nga Rafael Dushuzsky, si përfaqësues i autorizuar me prokurë,

Dhe

Nexhip Hajdëraj, shtetas shqiptar, i biri i Kujtim, lindur në Ballsh, me 14.12.1972, banues në Rruga “Xoxi Andoni”, Nd. 15, H. 1, 9302, Fier, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal H21214064A,

Dhe

Arefi Jakupllari, shtetas shqiptar, i biri i Fuat, lindur në Pogradec, me 01.05.1963, banues në Rruga “Demokracia”, Nr. 77, Pogradec, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal G30501145L, përfaqësuar nga Ardit Jakupllari, si përfaqësues i autorizuar me Prokurë të Posaçme,

Te cilet kane vendosur të themelojnë shoqërinë tregtare “ALB – CNG” Sh.p.k dhe të nënshkruajë këtë Akt Themelimi me kushtet dhe afatet si më poshtë:

Neni 1

Themelimi

Aksionaret kane vendosur të themelojnë Shoqërinë Aksionere me ofertë private “ALB – CNG” SH.A, këtu e më poshtë referuar si “Shoqëria”, person juridik shqiptar, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Neni 2

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është i pa limituar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

Aksioneret e Shoqërisë mund të vendosin limitin e kohëzgjatjes të aktivitetit të shoqërisë me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet në Rruga "Muhamet Gjollesha", Godina Qendra Tregtare Ring, Hyrja 2, Apartamenti nr.14, Tiranë, Shqipëri.

Neni 4

Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit i Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në sa më poshtë:

I. Ndërtimi i një impianti të kompresimit/lëngëzimit të gazit dhe një termocentrali,

- a) Sipërfaqja 20 - 50 mijë metra katrorë
- b) Të gjithë infrastrukturën e kantierit
- c) Tubacioni nga fusha / kolektori i gazit deri në kantier
- d) Kompresorë / turbozgjerues
- e) Depot e gazit
- f) Bombolat me vrima nxjerrëse
- g) Termocentrale për nevoja industriale dhe punë infrastrukturore.

II. Ndërtimi i një laboratorit të certifikuar për testimin e mostrave të gazit etj.

III. Importi dhe eksporti i gazit natyror, tregtia me shumicë dhe transporti i gazit natyror, Import-eksporti i hidrokarbureve, tregtia me shumicë dhe transporti i hidrokarbureve, kërkimi, si dhe çdo veprimtari tjetër fitimprurëse dhe në interes të shoqërisë.

Neni 5

Kapitali Themeltar - Aksionet

Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.000.000 (pesë milion) Leke, i ndare në 100 aksione të zakonshme, me vlere nominale të një aksioni prej 50.000 (pesedhjetë mijë) leke.

Aksionaret zoterojnë aksionet si më poshtë:

Blankbank Investments Limited ka 60 aksione, me 60% të pjeseve të kapitalit në një vlerë prej 3.000.000 (tre milion) Leke.

Arefi Jakupllari ka 30 aksione, me 30% të pjeseve të kapitalit në një vlerë prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Leke.

Nexhip Hajderaj ka 10 aksione, me 10% të pjeseve të kapitalit në një vlerë prej 500.000 (pesëqind mijë) Leke.

Neni 6

Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme – niveli më i larte i vendimmarrjes;
2. Këshilli Mbikqyres;
3. Administratori.

Struktura dhe organizimi i tyre përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 7

Këshilli Mbikqyres

Këshilli përbëhet nga 3 anëtarë të cilët caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyres caktohen për një periudhë 3 (tre) vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyres, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme janë:

Sergiy Probylov, shtetas ukrainas, i biri i Aleksandr, lindur në Ukrainë, datë 01.01.1967, banues në rr. Chernyshevska, nr.30, ap.11, 61002, Kharkiv, Ukrainë, mbajtës i pasaportës nr. FV282225.

Borys Syniuk, shtetas ukrainas, i biri i Boris, lindur në Ukrainë, datë 04.06.1952, banues në Rr.M. Dragomirova, nr.4, pp. 28, 01103, Kiev, Ukrainë; mbajtës i pasaportës nr. FU767210.

Kastriot Bejtaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimet, lindur në Fier, më 20.01.1958, me adrese ne Rruga “Andon Cajupi”, godina 23, hyrja 1, ap. 9, Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal F80120280V.

Neni 8

Administratori

Administratori i Shoqërisë është Rafael Dushuzsky, atesia Boris, shtetas i Izraelit, lindur në BRSS, më 22.10.1975, mbajtës i Pasaportës nr. 23985797, me adrese ne Haxav 10 /30, Nof ha Galil 17581, Izrael, i cili caktohet për një periudhë tre (3) vjecare, me të drejtë rizgjedhje.

Neni 9

Eksperti kontabël i autorizuar



Auditi financiar i Shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë ekspert/ë i/të autorizuar dhe të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme për një vit ushtrimor. Eksperti Kontabël i parë i caktuar do të jetë Kreston Albania sh.p.k., regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT L42007012I, me perfaqesues administratorin e saj Ekspert Kontabel i Autorizuar Rezar Llukaçej, me Certificate nr. 202, date 04.10.2010.

Neni 10

Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi është hartuar në dy (2) kopje në gjuhët shqip dhe anglisht me te njeften vlere, dhe pasi është lexuar nga Aksionaret themelues te Shoqërisë, ai është nënshkruar pa kundërshtime.

AKSIONARET THEMELUES

Blankbank Investments Limited

Përfaqësuar me Prokurë nga:

Rafael Dushuzsky

Dushuzsky RAFAEL
[Signature]

Nexhip Hajdëraj

Nexhip Hajdëraj
[Signature]

Arefi Jakupllari

Përfaqësuar me Prokurë nga:

Ardit Jakupllari

Ardit Jakupllari
[Signature]